

# PROKURIMI PUBLIK NË KOMUNA

(Periudha e monitorimit Janar – Qershor 2019)

Cilat janë rreziqet të cilat që po i imponohen komunave të **Prizrenit, Suharekës, Ferizajt, Lipjanit, Podujevës** dhe **Istogut** në mungesë të udhëzimeve adekuate ligjore?

1.

Komunat kanë pranuar nga ofertuesit vetëm certifikatën e gjykatës që nuk janë në proces të falimentimit<sup>1</sup>, por jo edhe që nuk janë të dënuara për krime<sup>2</sup>.

3.

Në mungesë të udhëzimeve të mirëfillta nga Komisionit Rregullativ i Prokurimit Publik lidhur me detyrimet nga ligji i punës, Komuna e Ferizajt në tenderin për sigurimin fizik të objektit të komunës dhe objekteve të tjera të cilat funksionojnë në kuadër të komunës kishte pranuar një ofertë prej 224€ për çdo punëtor që do të paguhej 270€ bruto pa e definuar se çfarë do të mbuloj kjo shumë. Ndërsa Komuna e Lipjanit, në tenderin për të njëjtat shërbime, kishte pranuar një ofertë që mbulonte vetëm rrogat e punëtorëve, dhe nuk përmbushte asnjë detyrim nga ligji i punës.

2.

Për shkak të kundërshtimeve ndërmjet ligjit primar<sup>3</sup> dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik<sup>4</sup>, komunat kishin shkelur dispozitat e paracaktuara në Ligjin e Prokurimit Publik lidhur me afatin e ankesave nga Operatorët Ekonomik.

4.

Në mungesë të standardizimit të kërkesave për kategoritë e prokurimit, Komuna e Podujevës në tenderin për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Shajkoc, Batllavë, Svegël, Ballovc, Lladovc, Livadicë dhe Surkish nuk kishte definuar kapacitetet motoriste të nevojshme për implementimin e kontratës, duke rrezikuar që kontratën të fitonin kompani të cilat nuk kishin kapacitete të mjaftueshme, ndërsa Komuna e Prizrenit, në tenderin për furnizim me zhavorr për rrugët e pa-asfaltuara, kishte përdorur kritere favorizuese për biznese të mëdha.

<sup>1</sup>Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 65.4

<sup>2</sup>Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 65.3

<sup>3</sup>Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 108/A

<sup>4</sup>Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, Neni 43